



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDRYSHE**

16 shkurt 2015, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA**

**Komuna e Prizrenit ka mbyllur 2014-n me fatura të papaguara në vlerë 2.2 milionë euro**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajit shkurt ka analizuar Raportin vjetor financiar të Komunës së Prizrenit, për periudhën janar-dhjetor 2014.

Raporti vjetor financiar i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave tregon se vitin e kaluar Komuna e Prizrenit ka vazhduar dobësitë në performansën buxhetore, pasi që vitin 2014 e ka mbyllur me mbi 2.2 milionë euro borxhe të papaguara.

Pasqyra e faturave (obligimeve) të papaguara të Komunës së Prizrenit tregon se në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale shuma e borxheve arrin në afër 1.9 milionë euro, derisa borxhi i papaguar për mallrat dhe shërbimet është 124 mijë euro, për shpenzimet komunale është 46 mijë euro si dhe 10 mijë euro për subvencione.

Arsyetimi i zyrtarëve përgjegjës komunal është se këto borxhe figurojnë në Raportin Financiar për shkak se shumë projekte nisin në gjashtë mujorin e dytë dhe se realizimi dhe pagesat barten në vitin tjetër.

Një rrezik tjetër për buxhetin e Komunës së Prizrenit, sipas Raportit vjetor financiar janë edhe detyrimet kontingjente. Shuma e këtyre detyrimeve sipas DEF-it në vitin 2014 ka arritur në shumën prej 3.2 milionë eurove, në krahasim me vitin 2013 kur ato kanë qenë në shifrën 2.1 milionë euro.

Muajin e kaluar, EC Ma Ndryshe pat raportuar se Komuna e Prizrenit ka thelluar performansën e dobët buxhetore (linku i komunikatës: [http://online-transparency.org/repository/docs/Komunikate %281%29 15012014.pdf](http://online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_%281%29_15012014.pdf)). Nga Komuna e Prizrenit ishin kërkuar sqarime se përse gjatë vitit 2014 është rritur shuma e borxheve të arkëtueshme dhe përgjigja e zyrtarëve të DEF-it ka qenë se të gjitha sqarimet do të jenë në Raportin vjetor financiar.

Ky Raport konfirmon se borxhet që duhet të arkëtohen nga Komuna e Prizrenit në emër të hyrave vetjake janë rritur gjatë vitit 2014, për afër 3 milionë euro. Përderisa në vitin 2013 shuma e borxheve të arkëtueshme ka qenë 11.65 milionë euro, në vitin e kaluar kjo shifër është rritur dhe ka arritur tanimë në 14.5 milionë euro.

EC Ma Ndryshe i bën thirrje edhe njëherë qeverisë komunale që t'i zbatojë standardet e qeverisjes së mirë, të cilat janë: përqendrimi në rezultate që janë në dobi të qytetarëve; sigurimi se qytetarët marrin shërbime të mira, me vlerë të shtuar për taksat e tyre; llogaridhënia; promovimi i vlerave të institucionit, duke dhënë shembull me sjellje të përgjegjshme dhe menaxhim të mirë të buxhetit dhe vendimmarrja transparente.

Për këto arsye EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Të merr masa adekuate për përmirësimin e performansës buxhetore;
- Të hartoj një plan të duhur për pagesën e faturave të papaguara;
- Të hartoj një plan të duhur për arkëtimin efikas të hyrave vetjake;
- Të zbatoj pa asnjë vonesë dhe në përpikëri rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm; dhe
- Të paraqet faturat e detajuara dhe jo raportet e përmbledhura, për të dëshmuar transparencën dhe llogaridhënien përballë publikut.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit, të Mamushës dhe të Prishtinës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
 OJQ EC Ma Ndryshe  
 Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
 Rr. Perandori Dioklecian 14 (kati V) - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
 +381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
 Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*